



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 14.11.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj - kryetare e Komisionit

Rendi i ditës :

1. Shqyrtim i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin “Për ekzekutimin e vendimeve penale””.

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Myslim Murrizi, Elona Hoxha, Sadi Vorpsi, Antoneta Dhima, Luan Duzha, Luan Harusha, Spartak Braho, Elena Xhina, Anduel Xhindi, Eljo Hysko, Edmond Rrushi, Lefter Maliqi, Nimet Musaj, Ylli Shehu, Arlind Çaçani.

Mungojnë:

Alban Zeneli, Xhemal Qefalia, Paulin Sterkaj dhe Arben Elezi.

Të ftuar:

Etilda Gjonaj- Ministër i Drejtësisë

Ëngjëll Hysi- Drejtor i komanduar i Shërbimit të Provës.

Evis Fico- Këshilltare e ministres

Ilir Bejko- Drejtor në Drejtorinë e Oponencës Ligjore.

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Sigurinë Kombëtare. Në rendin e ditës sot kemi ligjin “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, në fakt janë disa ndryshime që propozohen rishtas në këtë ligj, që i përket vitit 1998.

Për të prezantuar projektin kemi: ministren, zonjën Etilda Gjonaj. Mirë se erdhe!

Zotin Ëngjëll Hysi, drejtor i komanduar i Shërbimit të Provës.

Faleminderit!

Zonjën Evis Fico, këshilltare e ministres dhe zotin Ilir Bejko, drejtor në Drejtorinë e Oponencës Ligjore.

Ju kujtoj se më herët projektin e kemi pasur në kalendarin e punës së këtij komisioni, por për arsye objektive nuk ka qenë i mundur prezantimi i ndryshimeve të sjella në këtë projektligj. Meqenëse në Konferencën e Kryetarëve është miratuar që ky projekt mund të miratohet në seancën plenare në datën 12 dhjetor, në mos gaboj, na duhet që si komision për dhënie mendimi të fillojmë punën me këtë projektligj.

Pa humbur kohë do t’ia kaloj fjalën zonjës ministre. Dua të bëj me dije kolegët se relatore për këtë projektligj është caktuar zonja Elena Xhina.

Fillojmë me prezantimin në parim të projektligjit. Fjalën më pas do ta ketë relatorja. Pastaj kolegët sipas Rregullores mund t’u drejtojnë pyetje ministres, stafit të saj, si edhe relatores.

Zonja Ministre, fjala është për ju.

Etilda Gjonaj – Faleminderit!

E nderuar zonja kryetare,

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Ashtu siç e kam deklaruar edhe një herë tjetër në Komisionin e Sigurisë ne po përgatisim edhe me mbështetjen e aktorëve ndërkombëtarë të gjithë paketën e ndryshimeve ligjore të organeve ligjzbatuese, duke përfshirë edhe ligjin “Për shërbimin e provës” si një projektligj të ri, por edhe ligjin “Për Policinë e Burgjeve” dhe ligjin “Për trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve”.

Ligji “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, ndryshimet për ekzekutimet e vendimeve penale, po ashtu edhe projektligji “Për shërbimin e provës” janë depozituar në Kuvend në të njëjtën kohë dhe do të sugjeroja që të dyja projektligjet të diskutohen në të

njëjtën kohë meqenëse janë komplementare të njëri-tjetrit dhe ndryshimet që vijnë për ligjin “Për ekzekutimin e vendimeve penale” janë duke plotësuar dhe duke larguar ato dispozita nga ky ligj, të cilat i përkasin shërbimit të provës. Kjo mbetet në vlerësimin tuaj. Ky ishte një sugjerim për ta bërë diskutimin më të dobishëm.

Nëse më lejoni, po paraqes shkurtimisht disa nga argumentet për domosdoshmërinë e ndërhyrjeve që janë bërë në këtë ligj, që për hir të së vërtetës ka pësuar ndryshime të herëpashershme.

E para ka të bëjë me atë që u pa si i domosdoshëm harmonizimi i legjislacionit ekzistues me Kodin e Drejtësisë Penale për të Miturit i hyrë në fuqi rishtazi, pasi ky i fundit përmban disa rregullime të posaçme lidhur me ekzekutimin e vendimit penal, si dhe çdo mase tjetër që përfshin një të mitur në konflikt me ligjin.

Mund të them se janë evidentuar një sërë vështirësish nga organet kompetente për zbatimin e dispozitave të ekzekutimit të masave mjedisore dhe zbatimit të tyre në praktikë, tashmë një problem i trashëguar, një problem më shumë e 20 vjeçar, por si Avokati i Popullit ashtu dhe organizatat jofitimprurëse vazhdimisht kanë shprehur shqetësimin lidhur me nevojën urgjente për ndërtimin e institucioneve të veçanta për këtë kategori personash me masë mjekësore, të cilët në mënyrë kategorike nuk duhet të qëndrojnë brenda sistemit penitenciar, por duhet të qëndrojnë në institucionin mjekësor të posaçëm, i cili pavarësisht faktit që nuk është ndërtuar ende dhe është një institucion që është në administrimin e Ministrisë së Shëndetësisë në ligjin “Për shëndetin mendor”, por ruajtjen fizike duhet ta bëjnë strukturat e Ministrisë së Drejtësisë.

Përtej kësaj janë marrë një sërë masash edhe me KE-në, për të bërë të mundur që ky institucion të ngrihet sa më herët. Jemi në fazën ku po tentojmë të sigurojmë fondet për ngritjen e këtij institucioni të kërkuar edhe nga Komiteti i Parandalimit të Torturës.

Ashtu siç e përmenda më lart, është e domosdoshme ndërhyrja legjislative për harmonizimin e legjislacionit aktual me dispozitat e projektligjit “Për shërbimin e provës”, i cili është depozituar dhe planifikohet të miratohet, duke marrë në konsideratë që ligjvënësi ka synuar të bëjë një ndërhyrje legjislative. Duke diskutuar më pas për të miratuar projektligjin “Për shërbimin e provës” është e nevojshme të rishikohen një sërë dispozitash që gjenden në këtë ligj, të cilat automatikisht përbëjnë rregullime të detajuara lidhur me strukturën, organizimin dhe funksionimin e institucionit të shërbimit të provës. Kjo është parë si një domosdoshmëri për ndërhyrjet që kemi sugjeruar.

Ka pasur dhe janë evidentuar një sërë vështirësish dhe mungesash për efektivitetin në ekzekutimin e vendimeve penale me gjysmë lirinë si një dënim i ri alternativ, për sa u

përket institucioneve ku vendosen të dënuarit. Janë evidentuar zvarritje të panevojshme dhe të pajustificuara të procedurave për ekzekutimin e vendimit penal, si dhe mungesa e efektivitetit për shkak të mospërcaktimit të afateve kohore, të sakta, të prera të vendosura për mbarëvajtjen e procesit të ekzekutimit të vendimit penal nga ana e organeve kompetente në ligj.

Është vënë re mungesa e parashikimeve ligjore lidhur me ekzekutimin e dënimit të heqjes së përgjegjësisë prindërore, ku sot organet e shërbimit përmbarimor shtetëror më së shumti se atij i bie barra, por edhe ato private kanë një vështirësi të jashtëzakonshme për të ekzekutuar vendimet që kanë të bëjnë me dënimin për heqjen e përgjegjësisë prindërore.

Ka një zbatim jo të duhur të dispozitave lidhur me ekzekutimin e dënimit plotësues siç është nxjerrja jashtë territorit, dënimi me konfiskim dhe ndalimi i ushtrimit të detyrave shtetërore, por edhe një mospërcaktim të qartë i përgjegjësisë administrative apo dhe penale të organeve të përcaktuara në ligj, siç është rasti në prokurori, për ekzekutimin e vendimeve penale në rast të mosekzekutimit të tyre në përputhje me dispozitat procedurale dhe materiale.

Praktika ka vërtetuar se prokurorët pranë Gjykatës së Shkallës së Parë ka pasur raste që nuk zbatojnë me rigorozitet kërkesat e nenit 463 të Kodit të Procedurës Penale, ku ata ngarkohen të marrin masa për ekzekutimin e vendimit dhe kur është rasti të ndërmarrin kryerjen e veprimeve të veçanta nga prokurori i një rrethi. Në të gjitha rastet zbatohen kërkesat e nenit 463, pika 4, të Kodit të Procedurës Penale, të cilat detyrojnë prokurorin për të njoftuar me shkrim gjykatën që ka dhënë vendimin menjëherë që ka filluar apo ka përfunduar ekzekutimin e vendimit.

Dy janë objektivat kryesore: rritja e efektivitetit të zbatimit të ligjit “Për ekzekutimin e vendimeve penale” nga subjektet që u adresohet ky ligj, por edhe rritja dhe forcimi i bashkëpunimit, bashkërendimit dhe koordinimit midis organeve përgjegjëse të parashikuara nga ligji.

Shkurtimisht disa nga risitë dhe ndryshimet që kanë ardhur në këtë projektpropozim. E para ka të bëjë me përgjegjësinë e prokurorit në rast të mosekzekutimit të vendimit. Në projektligj me ndryshimet e ardhura parashikohet shprehimisht: nëse prokurori pa shkaqe të përligjura nuk ekzekuton vendimin në përputhje me përmbajtjen e tij mban përgjegjësi. Kjo përgjegjësi mund të jetë si administrative, ashtu dhe penale. Ka një diskutim, që për sa kohë ka një parashikim ligjor në Kodin e Procedurës Penale apo që përbën edhe një ndër shkaqet që prokurori të ketë përgjegjësi disiplinore, mund të

konsiderohet nëse duhet të jetë patjetër në këtë ligj për ekzekutimin e vendimeve penale apo jo.

Ne e kemi çmuar duke e marrë në konsideratë se ka qenë një problematikë shumë e theksuar dhe për këtë arsye kemi menduar që ta parashikojmë si një ndryshim në ligj.

Nëpërmjet projektligjit, parashikohet detyrimi i gjykatës në rastet e vendimit me ekzekutim të menjëhershëm për të urdhëruar ekzekutimin e vendimit në momentin e shpalljes së tij. Ka një riformulim midis dispozitave, të cilat pa dyshim i japin gjykatës urdhërimin që ajo të urdhërojë menjëherë pas shpalljes ekzekutimin e vendimit të dhënë prej saj.

Një ndryshim tjetër që vjen me këtë projektligj me këto ndryshime është se Policia e Shtetit me ndryshimet e propozuara do të jetë përgjegjëse për ekzekutimin e vendimeve penale ndaj të dënuarve në gjendje të lirë dhe dënimeve plotësuese të parashikuara në pikat 2, 3, 7, 8 dhe 10. Për dënimet plotësuese që unë i përmenda pak më lart dhe në ligjin e pandryshuar kompetencat e Policisë së Shtetit kanë qenë më përgjithësuese, ndërkohë që nëpërmjet ndryshimeve kompetencat e Policisë së Shtetit saktësohet, si dhe zgjerohen për sa u përket këtyre dënimeve plotësuese.

Një risi tjetër, vjen edhe nga ana teknike për sa i përket njoftimit që prokurori i bën të dënuarit duke pasur detyrimin njëkohësisht edhe për publikimin e vendimit penal. Kjo është vetëm për të lehtësuar dhe për të thjeshtuar komunikimin midis prokurorit dhe të dënuarit.

Një ndryshim tjetër që kemi sugjeruar në këtë projektligj ka të bëjë me dispozitat që kanë të bëjnë me vendimet e sekuestrimit kur jepet një vendim konfiskimi, të cilat duhet të jenë të ekzekutueshme menjëherë, ndërkohë që projektligji saktëson formulimin duke vendosur në rendin e duhur, se vendimet e konfiskimit, janë vendime me ekzekutim të menjëhershëm në rastet kur më parë është vendosur sekuestrimi si masë provizore.

Vendimet e formës së prerë, para ndryshimit ekzekutoheshin duke vënë në lëvizje prokurorinë kryesisht ose duke i dërguar vendimin nga gjykata menjëherë pas marrjes së formës së prerë.

Me ndryshimet e projektligjit, në kuadër të rritjes së efikasitetit për të përshpejtuar ndërveprimin institucional dhe për të shmangur burokracitë që mund të shfaqen gjatë procedurës së tërheqjes së vendimeve penale nga prokuroria, kësaj të fundit i është hequr detyrimi dhe e drejta për të tërhequr vendimet penale dhe për të vënë vetë në lëvizje procedurën e ekzekutimit. Këtë detyrim e ka vetëm gjykata, e cila menjëherë me marrjen e formës së prerë të vendimit, i dërgon prokurorit vendimin e shkurtuar. Ky ka ardhur si një

propozim nga problematikat që janë evidentuar në praktikë dhe që janë paraqitur në Ministrinë e Drejtësisë.

Një sërë ndryshimesh janë për të rregulluar terminologjinë juridike në dispozitat që kanë qenë në ligj.

Nga ana tjetër ka një rregullim të ekzekutimit të dënimit alternativ, siç e përmenda të gjysmëlirisë. Para ndryshimeve institucionin e ekzekutimit të këtij dënimi e vendoste administrata e burgjeve në nivel vendor dhe Shërbimi i Provës, ndërkohë që me ndryshimet është parë e nevojshme që institucionin e ekzekutimit të gjysmëlirisë e përcaktojnë Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Shërbimi i Provës. Ne jemi në fazën kur unë si ministre e Drejtësisë kam nxjerrë një urdhër ku kërkoj riklasifikimin për sa i përket institucionit që do të ekzekutojnë vendimet me gjysmëliri. Sot është përcaktuar se ky institucion është institucioni i Vaqarit.

Në kuadër të harmonizimit të legjislacioneve projektligji synon padyshim harmonizimin me ligjin “Për shërbimin e provës”.

Janë edhe një sërë ndryshimesh që kanë të bëjnë me shfuqizimin e disa parashikimeve, duke shfuqizuar detyrimin e Shërbimit të Provës për të përfshirë në raport elemente për prejardhjen e të dënuarit që është konsideruar se përmbajnë elemente diskriminuese dhe jo të përshtatshme.

Gjithashtu, janë shfuqizuar dispozitat që parashikonin rregullat mbi funksionimin dhe veprimtarinë e Shërbimit të Provës duke mbajtur në konsideratë që do të jetë një projektligj më vete.

E përmenda pak më herët se domosdoshmëria e ndërhyrjeve ka të bëjë pikërisht me heqjen e kompetencave të shërbimit përmbartimor për ekzekutimin e vendimeve penale që përmbajnë dënim plotësues, siç është konfiskimi i mjetit të kryerjes së veprës penale. Në nenin 40 të ligjit parashikohet se konfiskimi i mjeteve të kryerjes së veprës penale bëhet drejtpërdrejt nga prokurori në bashkëpunim me Policinë e Shtetit.

Për sa u përket ndryshimeve që parashikohen për dënimet plotësuese, të cilat i përmenda edhe si domosdoshmëri, para ndryshimeve parashikohej se dënimet plotësuese zbatoheshin nga organi, i cili ka emëruar apo ka lidhur një marrëdhënie pune me të dënuarin, ndërsa me ndryshime e bëra parashikohet se dënimin plotësues të ndalimit të ushtrimit të detyrave shtetërore e zbaton organi, të cilit i paraqitet kërkesa për punësim ose që ka tagër të emërojnë personin.

Nga ana tjetër, është ndryshuar, gjithashtu, përmbajta mbi zbatimin e dënimit plotësues për ndalimin e ushtrimit të një veprimtarie apo mjeshtërie, duke parashikuar që

tashmë organi i cili lëshon lejet apo autorizimet për ushtrimin e veprimtarive/ mjeshtërive nuk tërheq dokumentin, por i heq personit të drejtën për të ushtruar këtë veprimtari apo mjeshtëri.

Për sa i përket heqjes së përgjegjësisë prindërore është parashikuar që Policia e Shteti pranë vendbanimit apo vendqëndrimit të fëmijës, organi kompetent për ekzekutimin e këtij vendimi do të jetë pikërisht policia, nëpërmjet urdhrit të vënë në dispozicion nga prokurori, duke mbikëqyrur dhe kontrolluar zbatimin vendimit të gjykatës dhe duke ia hequr si përgjegjësi përmbarimit shtetëror.

Ka disa ndryshime që janë propozuar, ashtu siç thashë, për ta sjellë në përputhje me kodin e drejtësisë penale për të miturit. Institucionet e posaçme të edukimit të të miturve riemërtohen si qendra apo institucione publike apo private të pajisura me infrastrukturë dhe personelin e duhur për të përbushur nevojat e veçanta të të miturve.

Gjithashtu, projektligji bën edhe një rregullim konciz në lidhje me ekzekutimin e dënimeve ndaj personave juridikë.

Së pari, saktëson terminologjinë e përdorur nga masa penale në dënime kryesore apo dënim me gjobë, si dhe shton organet që ekzekutojnë urdhrin e prokurorit mbi vendimin e gjykatës në rastin e mbylljes së personit juridik, ku praktikisht është QKB-ja për shoqëritë tregtare dhe gjykatat për OJF-të.

Gjithashtu, me anë të këtij ndryshimi, me ligjin synohet plotësimi i kuadrit ligjor mbi dënimet plotësuese në rastin e dënimit të personave juridikë, duke shtuar gjithashtu një dispozitë të re.

Drejtësia penale për të miturit është tashmë një sfidë dhe një prioritet që vazhdon dhe plotësimi i kuadrit ligjor është një hallkë kyçe.

Krahas me ndryshimet e tjera, këtij projektligji i shtohen tri dispozita mbi ekzekutimin e dënimeve për të miturit dhe një nga këto është parashikimi i rregullave mbi ekzekutimin e dënimeve jo me burg për të miturit, ku një rol të rëndësishëm ka Shërbimi i Provës në ekzekutimin e këtyre vendimeve.

Rregulla të posaçme parashikohen edhe për dënimin me burg dhe dënimin me gjobë ndaj të miturit.

Në lidhje me kompetencën e organeve për kontrollin e ekzekutimit të vendimit synohet qartësimi i ligjit duke shmangur terminologji jo të përshtatshme, duke shpjeguar qartësisht ato dispozita të cilat shpeshherë janë ekzekutuar jo në mënyrë të drejtë për shkak të kësaj terminologjie jo shumë të saktë.

Këto ishin disa nga risitë që sjellin ndryshimet e propozuara. Padyshim që do të ishte më e plotë të ishte diskutuar bashkë me projektligjin “Për Shërbimin e Provës”, por mbetet në vlerësimin tuaj si komision.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Ministre!

Është e vërtetë që në Kuvendin e Shqipërisë janë paraqitur tre projektligje: “Ndryshime në ligjin për ekzekutimin e vendimeve penale”, të cilin ju sapo e prezantuat, “Ndryshime në ligjin “Për Shërbimin e Provës””, si dhe projektligji “Për Policinë e Burgjeve”.

Në momentin kur këto projektligje kanë ardhur në Kuvendin e Shqipërisë, në Konferencën e Kryetarëve neve nuk na është bërë më dije që kjo ishte një paketë, kështu që projektligjin “Për Shërbimin e Provës”, tek i cili ne jemi komision për dhënie mendimi, ne e kemi shqyrtuar paraprakisht dhe sugjerimet tona ia kemi përcjellë komisionit përgjegjës, që është Komisioni i Ligjeve.

Mendoj se jemi akoma në kohën e duhur, përderisa shqyrtimi i këtyre ligjeve nuk i ka kaluar seancës plenare për t’i parë të tre së bashku dhe për të mundësuar që të harmonizohen në mënyrën më të mirë të mundshme.

Dua të theksoj, para se t’ia jap fjalën relatores, se janë disa ndryshime, janë gati 38 ndryshime që bëhen në ligj. Është një ligj i vitit 1998 në të cilin është ndërhyrë dy herë. Ndërhyrja e fundit është bërë vitin e shkuar, kështu që besoj se meriton vëmendjen e të gjithëve, edhe për të kuptuar se kjo nevojë e ndryshimeve në këtë ligj lindi kaq shpejt, në harkun kohor të një viti, dhe pse nuk është gjykuar që të kishim një ligj të ri, nëse ndërhyhet kaq shpesh në ligjin ekzistues.

Urdhëroni, relatorja!

Elena Xhina - Faleminderit!

Falënderoj ministren për parashtrimin e projektligjit! Në fakt, ministrja na solli arsyet, shkaqet që e kanë shtyrë për ta sjellë këtë projektligj para Kuvendit.

Siç e thatë edhe ju, zonja kryetare, ky është një ligj i vitit 1998. Ka pësuar ndryshime në vitin 2008 dhe në vitin 2018. Meqenëse nuk dua të përsëris dispozitat që do të ndryshohen, do të kërkoja leje të kaloja direkt në një diskutim.

Gjatë fjalës së zonjës Ministre, por edhe gjatë përgatitjes së relacionit, një nga arsyet kryesore që ngrihet është fakti se kërkohet të bëhet një harmonizim i këtij projektligji me Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur, që realisht mendoj se duhet të ishte bërë, pasi më rezulton se ky kod është miratuar më 30.3.2017 dhe ka hyrë në fuqi më 1.1.2018, ndërkohë

që ndryshimet e fundit që i përkasin projektligjit që po diskutojmë i takojnë nëntorit të vitit 2018.

Pyetja ime e parë është: Pse nuk janë bërë këto ndryshime që këtë vit, pasi në Kodin e Drejtësisë Penale ne e kemi pasur të hyrë në fuqi dhe nuk janë prekur këto dispozita?

Do t'i qëndroja përsëri fort pyetjes që bëri zonja kryetare: Pse nuk mendohet për bërjen e një kodi të ri, meqenëse, me sa dimë, nga Ministria e Drejtësisë është duke u punuar edhe kodi i ri penal edhe në këtë frymë? Pse nuk mendohet që të sillet një ligj i ri për ekzekutimin e vendimeve penale, pasi ekzistuesi i përket i vitit 1998 dhe mjaft shprehje të përdorura ose teknika legjislative e atyre viteve nuk i përshtatet më dinamikës së zhvillimit, as legjislacionit që ne tashmë disponojmë, por edhe ndryshimeve që kanë ardhur me ligjet e reja, të hyra në fuqi?

Nga ana tjetër, pyetja që unë ngre lidhet me faktin që në këtë projektligj ndryshojnë disa kompetenca, si me Policinë e Shtetit, me shërbimin përmbarrimor. A është parë më kujdes nga ana e grupit të punës harmonizimi i këtij projektligji me dispozitat e Kodit Penal, Kodit të Procedurës Penale, Kodi i Procedurës Civile, ligjin "Për shërbimin përmbarrimor shtetëror", s'po përmend ligjin për Shërbimin e Provës dhe Policinë e Burgjeve, sepse ato i kemi ndërkohë në studim?

Në këto kushte për mua është shumë e rëndësishme të di nëse është bërë ky harmonizim apo jo, sepse vërtet ne heqim disa kompetenca, por këto kompetenca janë dhënë në një ligj tjetër, i cili mund të jetë edhe ligj që është miratuar me ¾. A mundemi të bëjmë këto lloj ndërhyrjesh në ligj?

Një diskutim tjetër është për faktin që ju kërkoni që nëpërmjet dispozitave të reja të sjella në këtë projektligj të ngarkoni me përgjegjësi administrative apo penale prokurorin.

Unë personalisht, nuk e gjej me vend të ndërhyj, megjithatë kjo do t'i nënshtrohet diskutimit që ne do të bëjmë nën për nën duke marrë edhe mendimin e anëtarëve. Unë ngre pyetjen: Kur prokurori e rregullon funksionin e tij nëpërmjet ligjeve të cilat janë specifike dhe të miratuara me shumicë të cilësuar në Kuvend, për më tepër, në ligjin aktual, në nenin 8, paragrafi i parë, ne kemi përcaktuar përgjegjësinë e personave që nuk ekzekutojnë apo zvarrisin vendimet penale dhe ata mbajnë përgjegjësi administrative ose penale, sipas ligjit aktual, mos kemi nga njëra anë mbivendosje brenda të të njëjtit ligj, ligjit aktual që jemi duke e shqyrtuar, por, nga ana tjetër, mbivendosje të ligjeve specifike, me të cilat ushtron funksionin prokurori me ligjin e thjeshtë që jemi duke e shqyrtuar?

Gjithashtu, doja të bëja një sqarim, sepse rezulton në relacion që ministria i referohet nenit 30 të Kodit Penal, pikës nr.10. Dua të sqaroj se ky ka qenë një diskutim që ne e kemi

pasur kur ka qenë Kodi Penal në ndryshimet në diskrim. Është bërë një propozim që të shtohet një pikë nr. 11, por në fakt u hoq dorë në seancë dhe nuk ka pikë nr. 11 (ndalimi i daljes jashtë shtetit) në nenin 30 të Kodit Penal.

Kjo ishte thjeshtë për të sqaruar anëtarët e komisionit. Këto janë diskutimet që doja të shtroja.

Më pas gjatë diskutimit nën për nën do të kemi mundësi ta shohim edhe më qartë për rregullimet e teknikës legislative dhe harmonizimin me ligjet e tjera. Sot do të kërkoja nga të gjithë anëtarët e komisionit, meqenëse projektligji ka adhur sipas Rregullores së Kuvendit në përputhje me Kushtetutën ta kalojmë dhe ta miratojmë në parim, për të na u dhënë mundësia që ta diskutojmë nën për nën.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Xhina!

Marr shkas nga propozimi juaj i fundit dhe dua edhe mirëkuptimin tuaj dhe të kolegëve, gjithashtu edhe të zonjës Ministre, nëse mundemi të fillojmë me pyetjet për të gjithë kolegët dhe pastaj ministrja të mund të përgjigjet në bllok, meqenëse ne do të ndalemi gjithsesi të shqyrtimi nën për nën.

Kush ka pyetje nga kolegët?

Urdhëroni, zoti Murrizi!

Muslim Murrizi - Faleminderit, zonja kryetare!

Megjithëse relatorja i shteroi pothuajse të gjitha pyejet, po ashtu dhe ju në parashtrimin që i bëtë relatores, unë kam këtë pyetje: Cila është arsyeja, zonja Ministre, që vjet është ndryshuar ligji dhe pa u mbushur viti vjen prapë në Kuvend për t'u ribërë? Unë nuk shoh ndryshime, shoh 38 nene. Mua më duket një ligj gati-gati i ri. A nuk ka ndonjë mundësi të marrim një ligj, meqenëse ky që është sot në futi është i vjetri, është i vitit 1998? A keni marrëdhënie me vendet e BE-së? Merrni një ligj nga BE-ja, nga një vend që kemi më afër, nga Italia, Gjermania, Franca, Greqia apo ku ta di! Merrni një ligj, përkthejeni dhe bëjmë një ligj nga e para për ekzekutimin e vendimeve penale! Se po vazhduam kështu, nga 38, 40 apo 50 nene në cdo 6 muaj quhen arnime. Të njëjtën rezervë kam pasur edhe për Kodin Penal.

E dyta. Në relacionin shpjegues thoni se qëllimi i ligjit është në zbatim të Kodit të së Drejtës Penale për të Mitur. A është vetëm për të mitur ky ndryshim me 38 nene apo për të gjithë?

E treta. Përsëri në relacion thoni se në vlerësimin e projektit të raportit të programit, politikë e KM-së është reformimi rrënjësor dhe përsosja e mënyrës së rekrutimi të stafit policor dhe atij civil për të shmangur njëherë e mirë emërimet politike. Nga kush do t'i

shmangni emërimet politike? Kush ju ka penguar? Keni gjashtë vjet në pushtet. Ku ka pasur ndërhyrje? Ju hapët një ankand për drejtoritë e burgjeve, shpallët fituesit, thirrët ata që tha partia dhe i emëruat. Pastaj, serinë e dytë, hapët një ankand tjetër për drejtoritë e policisë së burgjeve. Për efekt të të marrurit me disa punë këto vite, pas prishjes së kooperativës, njoh një pjesë dërmuese të atyre që emëruat edhe në dorën e parë, edhe në dorën e dytë. A ka mundësi të na i kurseni, se po të mos i kisha parë këtu, nuk do të pyesja. Kur shoh se edhe i emëroni me porosi të partisë, edhe na e thoni këtu. Hi syve doni të na hidhni? Ne këtu jetojmë. Ky vend është kaq i vogël, sa mbushet me informacion për dy orë. Të gjithë ata që janë emëruar, për dhjetë minuta e marr vesh se kush i ka rekomanduar. A është bërë kështu edhe më parë? Po, të njëjtin surrat ka pasur administrata, që nga prishja e sistemit deri më sot, nën të gjitha partitë. Por na e hiqni këtë nën këtu, se na fyeni inteligjencën. Kur e lexoj që do ta votoj, them: Po këta, tallen me ne?

Nuk emëron dot asnjë drejtor. As atë që ke drejtor të përgjithshëm. E ke tri herë të shkarkuar atë, nga njëri e nga tjetri. Nuk e mbron dot ti. Ta ka thënë kolegu im Maliqi, në parlament. E njoh atë që ke aty. Ka qenë përgjegjës i elektrikut, e hoqët, erdhi te AKU-ja, e hoqët. Se mos e ke emëruar ti atë. Hiqeni këtë paragrafin këtu. S'po jua kërkon njeri. Pse e mbani kot?

A do t'i them me emra ata që ke emëruar ti, edhe drejtorë burgjesh, edhe drejtorë policie? Çfarë fitojmë? Hiç. Po këtë pjesën mos ma vër, se më duket sikur më tall. Kështu do të funksionojë ky vend, derisa të kthehet nga e mbara, inshallah, por nuk e di se kur do të kthehet.

Ti emëron drejtorë burgjesh, po s'firmosën deputetët? Jo.

Te vendimet penale, sepse duket sikur po të kërkoj llogari në mbledhje partie, por mos e vini për mua të paktën. Kur të keni mbledhje grupi, thuaj çfarë të duash në grupin tënd. Unë nuk duroj dot. Po të kisha duruar kaq shumë, do të kisha vdekur ministër te Berisha. Nuk duroj dot kur më tallin.

Numri i vendimeve penale të ekzekutuara dhe të paekzekutuara. Kam një tabelë këtu përpara. shoh se më i lartë është numri i vendimeve të paekzekutuara, se i atyre të ekzekutuara. Në vitin 2015 janë 3317 vendime të ekzekutuara, ndërsa 3700 janë të paekzekutuara. Vendime të mbartura, edhe ato të paekzekutuara, janë 2470.

Pra, për vitin 2015, janë në total 6170 vendime të paekzekutuara. Viti 2016 ka 6187, viti 2017 ka pësuar një ulje në krahasim me këto. Ka 3790.

Desha të dija që, ato janë të paekzekutuara ngaqë mungon vullneti i prokurorëve apo nuk ka qenë e mundur të ekzekutoheshin, sepse nuk gjenden këta, kanë marrë vendim të formës së prerë dhe nuk ekzekutohen.

A mendoni ju, se ndryshimi i këtij ligji e zgjidh përfundimisht dhe e çon në kah të kundërt raportin mes vendimeve të ekzekutuara dhe të paekzekutuara, pra e rrit ekzekutimin e vendimeve?

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Murrizi!

Meqenëse ishin disa pyetje, a mund të kemi përgjigjet për këto pyetje, zonja Ministre?

Etilda Gjonaj – Po i marr me radhë pyetjet.

E para, këto ndryshime vijnë një vit pasi u bënë ndryshime në ligjin “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, për arsye se paketa e parë, ndryshimet e para në lidhje me këtë projektligj, që u bënë në 2018-ën, erdhën si propozim dhe si pjesë e paketës së reformës në drejtësi. Qenë ndryshime imediate, të cilat ishin të depozituara dhe të propozuara me nismë të deputetit.

Projektligji ishte depozituar shumë kohë më përpara, dhe një sërë ndryshimesh që vijnë të propozuara, janë edhe për efekt të ndryshimeve që sjell paketa e re në lidhje me sistemin penitenciar dhe organet ligjzbatuese, siç janë Shërbimi i Provës, ligji “Për Policinë e Burgjeve” apo ligji “Për trajtimin e të dënuarve e të paraburgosurve”.

Duke mbajtur në konsideratë faktin se në kohën kur janë miratuar ndryshimet në 2018-ën, kjo paketë nuk kishte përfunduar, kështu që do të ishte e pamundur t’i bënim këto ndryshime, duke hequr procedurat, rregullat e ligjit “Për Shërbimin e Provës”, sot si dispozita të projektligji i ri, si dhe një sërë dispozitash të tjera, të cilat lidhen me Kodin e Drejtësisë Penale për të Miturit, që vijnë edhe si zbatim i një sërë rregullimeve të bëra me akte nënligjore, pas hyrjes në fuqi të kodit.

Është e vërtetë, edhe për mua përbën shqetësim fakti se ligjet ndryshojnë shpeshherë, ndaj kam edhe një merak tjetër: që ky ligj do të duhet të ndryshojë përsëri në momentin kur institucionet e SPAK-ut do të fillojnë nga puna. Kjo për faktin se, edhe së bashku me mbështetjen po mendohet për një paketë nënligjore apo ligjore, e cila do të jetë posaçërisht për t’i ardhur në ndihmë veprimtarisë që do të kryejë SPAK-u. Mbase në atë moment do të jetë koha për të bërë një ligj të ri për ekzekutimin e vendimeve penale nga fillimi.

Kjo ishte arsyeja që na duhet të propozonim në mënyrë imediate ndryshimet e atyre që lidheshin me funksionimin e shërbimit të provës në këtë lloj situatë dhe për përafrimin apo përqasjen me parashikimet e Kodit të Drejtësisë për të Miturit.

Padyshim, në të gjitha projektligjet e propozuara, por në veçanti edhe për ekzekutimin e vendimeve penale, janë parë, ashtu sikundër ju thatë, si një paketë. Padyshim, ka ardhur edhe ligji për trajtimin e të dënuarve e të paraburgosurve, duke e bërë atë si një paketë me katër projektligje. Është bërë koordinimi dhe është parë gjithë procesi për përafrimin e legjislacionit, jo vetëm i atij ekzistues, por edhe me ndryshime që sjellin këto katër projektligje.

Për sa i përket faktit që emërimet në burgje bëhen me porosi partiake, zoti Murrizi, unë ju kundërshtoj plotësisht në këtë pikë, për një arsye të vetme. Jam e bindur se po të interesoheni te Akademia e Sigurisë dhe po të shikoni procedurën se si rekrutohen sot punonjësit e Policisë së Burgjeve, ku asnjë polic burgu nuk hyn në sistem, po nuk kaloi nëpërmjet testit që bën Akademia e Sigurisë.

Nëse Akademia e Sigurisë bën testin për gjithë Policinë e Shtetit, jam e bindur se këtë e kryen më së miri edhe në lidhje me Policinë e Burgjeve. Ju e dini mjaft mirë se Policia e Burgjeve, kur bëhej popullimi i një institucioni me stafin policor, bëhej me lista partie, nga selitë e partive. Kjo gjë nuk ndodh sot.

U bë e katërta procedurë që ne kryejmë, një herë në tre muaj, në lidhje me rekrutimin e punonjësve të Policisë së Burgjeve. Po të ishte ashtu, që ne të përfshinim çdo person që merrnim, me lista partie, të jesh i bindur se sot nuk do të kishim vakanca në Policinë e Burgjeve, që janë rreth 70 punonjës të rolit bazë.

Për sa u përket shefave të policisë dhe drejtorëve të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale, unë ju ftoj në Ministrinë e Drejtësisë, ku mund të shikoni jo vetëm procedurën, por të shikoni edhe dosjet e secilit prej tyre, si dhe verifikimin që u është bërë, së bashku me formularët e dekriminalizimit, që në fund të fundit nuk ka qenë detyrim ligjor. Nëse ka pasur ndonjë rast kur vetë ata që kanë fituar konkursin dhe kanë kaluar të gjitha fazat për të qenë drejtues në institucione të ndryshme, kanë gënjyer apo kanë dhënë deklaratime të rreme, me firmën e tyre poshtë, padyshim ata persona janë referuar në organet përkatëse.

Gjithashtu, shefat e policisë janë ata punonjës, të cilët kanë më shumë se pesëmbëdhjetë vjet në ato institucione, dhe po t'i merrni të gjithë me radhë, të jeni të bindur se prurjet nga jashtë janë në nivele shumë të pakta. Jo se e nuk duam ne që të ketë prurje nga jashtë, ngaqë duam të mbajmë vetëm ata që janë aty, por kërkesat për të qenë shefa policie janë shumë të pakta, kjo edhe për shkak të masave që janë marrë nëpër institucione, edhe për

shkak të vështirësive, edhe për shkak të të gjitha masave që janë marrë për uljen e korrupsionit dhe të abuzimit me detyrën.

Nuk them se kemi ende problematika për korrupsionin apo të abuzimit me detyrën nga ana e punonjësve të Policisë së Burgjeve në të gjitha rolet, por të gjithë treguesit, për sa i përket rasteve të referuara në prokurori nga Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve në Ministrinë e Drejtësisë, tregojnë qartas se bëhet fjalë për masa shtrënguese të marra për goditjen e këtyre fenomeneve.

Nga ana tjetër, nuk duhet të harrojmë se edhe në lidhje me punonjësit e Policisë së Burgjeve, është ajo që theksova pak më parë: mungesa e dëshirës, e motivimit të njerëzve për të shërbyer në këto pozicione të vështira, por ndodh edhe për faktin se ka një presion të shtuar të këtyre pozicioneve dhe të detyrave brenda këtyre strukturave të burgjeve.

Për sa u përket vendimeve të paekzekutuara, kjo ka të bëjë me vendime të paekzekutuara nga Shërbimi Përmbarimor, në se jam korrekt sa i takon tabelës së cilët ju referuat. Ka të bëjë pikërisht me ndryshimin që ne kemi propozuar, që disa nga detyrat, përgjegjësitë që ka Shërbimi Përmbarimor Shtetëror për të ekzekutuar vendimet penale, të mos i kryejë, sepse nuk ka arritur t'i realizojë ato. Kjo, jo se nuk ka kryer detyrën apo nuk ka dashur, por kjo ka ndodhur edhe për shkak të mungesës së mjeteve përkatëse për të kryer këtë detyrë.

Kjo është arsyeja se përse janë bërë disa ndryshime dhe disa propozime, duke e marrë në konsideratë nga analiza që është bërë, që kjo do të përmirësojë ndjeshëm ekzekutimin e vendimeve të këtij karakteri.

Tani përgjigja për një pyetje të fundit, të cilën e lashë pa trajtuar. Ka të bëjë me pjesën e përgjegjësisë disiplinore, administrative apo penale që duhet të mbajë prokurori në rast të mosekzekutimit. Vërtet që është një dispozitë që gjen vend edhe në Kodin e Procedurës Penale, por edhe në ligjin për ekzekutimin e vendimeve penale, por ne kemi bërë një sugjerim për të shtuar në nenin 9, duke parashikuar edhe rastet kur, pa shkaqe të përligjura, përgjegjësia për mosekzekutimin e vendimit t'i mbetet prokurorit, si në mënyrë administrative ashtu edhe penale.

Unë e theksova edhe në fjalën time, se kjo mund të përbëjë edhe shkak për përgjegjësi disiplinore të prokurorit, në bazë të inspektimit që do të kryejë Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

Gjithsesi, padyshim që mbetet për t'u vlerësuar, ndaj jemi të hapur nëse do të ketë nevojë për ndryshim kur të diskutohet nen për nen.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Ju lutem, zoti Murrizi, vetëm diçka! Dakord, ju e shtruat problematikën që lidhet me Policinë e Burgjeve, por meqenëse ne do ta kemi atë ligj për diskutim, më duket e parakohshme të ezaurojmë një diskutim që do ta kemi të posaçëm në komision. Pra, do të ishte më produktive që ne të ndaleshim te ekzekutimi, mendoj unë. Megjithatë, dakord.

Myslim Murrizi – Faleminderit!

Të mos të duket sikur të kam thirrur në interpelancë.

Zonja Ministre,

Në fjalën time nuk ju thashë asnjë për policët e burgjeve, sepse e di se ata janë vrima e fundit e kavallit ata 5 mijë punonjës që ke në burgje. Numrin e të burgosurve e keni të barabartë me numrin punonjësve. Thashë për drejtorët e burgjeve. I keni bërë tender edhe drejtorët e Policisë së Burgjeve, policët po e po. edhe ata 70 që të kanë ngelur, për këtë arsye që them unë të kanë ngelur. Nuk janë rakorduar ende grupet e punës, për të sjellë emrat e atyre që duhet të vinë.

Keni hapur një konkurs tani. Kur e keni, në çfarë date? Apo e bëtë? E keni kryer apo do ta bëni tani? E di edhe atë. Unë nuk flas në tym, jam i azhurnuar. Të paktën atë ndërmarrjen tënde dhe ndërmarrjen e këtij Lleshit, përpiqem t'i njoh. Hera e tretë që jam në Kuvend, te ky Komision kam qenë. Pse, për policë thashë unë? 5000 policë ka aty, nuk është se i ke marrë me listë partie, por thashë për drejtorët e burgjeve dhe drejtorët e Policisë së Burgjeve. Meqë më thua që zbatojmë ligjin, vetëm drejtorë të përgjithshëm ke ndërruar 4 vetë për 6 vjet, një nuk e latë as të ngrohte sediljen, vetëm 4 muaj. A e kundërshton këtë që them për këtë që ke drejtor tani? Po të duash unë ta vë në dispozicion shkresën e shkarkimit të tij dhe për çfarë është shkarkuar nga ndërmarrja e parë, pastaj të them pse ka ikur nga ndërmarrja e dytë, por nuk dua të merrem se nuk është ky objekti i diskutimit, për më tepër që ai zotëria nuk është këtu. Ti mos merr përsipër të mbulosh çdo gjë! E di që nuk të vjen mirë, por ç'punë ke ti me të? Unë nuk po të them ty, kur ta kem këtu atë zotërinë, do t'ia them, do të ta jam letrën edhe ty, edhe pse ti e ke një kopje, por po ta jap jashtë kamerave, që të shohësh nga vjen, çfarë ka mbaruar, ku ka punuar, kush e ka hequr, pse është hequr dhe pse u hoq për herë të dytë.

Të kategoria e veprave të paekzekutuara të kam parë këto ditë që ke artikuluar se do të bësh një amnisti, ose po bën gati një ligj për amnistinë, se më shpëtoi nga pyetja e parë. A është e vërtetë që Ministria e Drejtësisë po përgatit një draft për amnistinë? A nuk do të ishte mirë që të dihet se çfarë kategori vepra janë vendimet e paekzekutuara? Nëse janë vepra penale, që nuk përbëjnë rrezik për shoqërinë, a mund t'i futësh te amnistia? Është një variant i

bankës që kur nuk i vjel dot më kreditë e këqija, i mbyll dosjet që të mos i mbajë për inventar kot. Po të kesh planifikuar amnisti për 2, 3 apo 5 vjet, apo ku di unë sa janë dënuar, në prag festash, futi edhe këta të gjithë dhe ta fillojmë një gjë nga zeroja, se po të vazhdojë kjo gjë me të mbartur, a e dini sa do të shkojë vitin tjetër, apo jo?

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Po, zonja Ministre!

Etilda Gjonaj – Zoti Murrizi, unë, përtej komenteve që mund të keni, që është plotësisht e drejta juaj, dua vetëm t’ju them që sot drejtuesit e burgjeve, me të gjitha vështirësitë që kanë dhe me të gjitha masat e rrepta të sigurisë që po zbatojnë në luftën kundër krimit të organizuar, kanë nevojë edhe për përkrahjen tuaj. E kemi diskutuar edhe në këtë komision, kur kemi folur për zbatimin e 41- biss-it, apo edhe për disa dispozita të pazbatuara ndonjëherë, që kanë të bëjë me izolimin e të dënuarve në rastet kur marrin vendimin e gjykatës për shkak se kanë kryer një shkelje të rregullit dhe thyerje të qetësisë. Për drejtuesit e institucioneve, ashtu dhe për drejtorin e përgjithshëm, unë mendoj se janë ndër njerëzit më me integritet nga kandidaturat e ofruara. Konkursi ka qenë i hapur për të gjithë drejtuesit e burgjeve, unë personalisht, kur kam marrë kandidaturat kanë qenë vetëm 50 prej tyre dhe sot kemi ende vende bosh si drejtues të institucioneve penitenciare për shkak...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Duhet të futen në konkurs, zoti Murrizi, se nuk e bëjmë dot selektive.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mund t’i sillni patjetër.

(Ndërhyrja pa mikrofon)

Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve nuk futet në konkurs sipas ligjit, sepse drejtori...

Ermonela Felaj – Zonja Ministre, a mund ta përmblihdni, që të mos kalojmë temën e diskutimit, se jemi te ekzekutimi, por po merremi me emërtesat në burgje.

Etilda Gjonaj – Keni shumë të drejtë, vetëm do të doja të ruanim etikën sidomos për ata drejtues, të cilët po japin maksimumin në të gjithë veprimtarinë dhe po kryejnë funksionin e tyre, prandaj do të doja t’i trajtonim me shumë respekt dhe të kenë mbështetjen tuaj, duke përfshirë edhe drejtorin e Përgjithshëm të Burgjeve.

Për sa i përket amnistisë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jam e hapur për çdo lloj interpelance.

Ne po përgatisim një draft për amnistinë, jemi në diskutime të vazhdueshme me prokurorinë, shumica e këtyre vendimeve nuk janë nga ato që mund të amnistohen, se një

pjesë e tyre kanë të bëjnë me kujdestarinë prindërore, kurse pjesa tjetër po shihen, që të jenë pjesë e draftit, por do ta shohim edhe sugjerimin tuaj.

Ermonela Felaj - Ju lutem a mund ta mbyllim këtu këtë pikë të diskutimit, se pastaj bëhet monolog? Ne u kemi kushtuar vëmendjen të gjitha institucioneve të sigurisë, përfshirë dhe burgjet, për t'i kontaktuar në vend dhe për të folur me drejtuesit e tyre. Natyrisht në të gjithë këtë lëvizje tonën ne kemi parë shembuj të burgjeve të administruar shumë mirë, por nuk duhet të mohojmë që burgjet ngelen një sektor i vështirë, ku vëmendja dhe reagimi duhet të jenë e shtuar. Unë mendoj se një nga këto janë edhe instrumentet e reja ligjore, që ne përpiqemi të propozojmë, apo të fusim si elemente të zbatimit praktik, me qëllim që të përmirësojmë punën dhe performancën e çdo drejtuesi nga ai i nivelit më të thjeshtë deri të ai i nivelit më të lartë në sistemin penitenciar.

Nuk e di nëse ka pyetje të tjera nga kolegët për ligjin “Për ekzekutimin e vendimeve penale”.

Në fakt, unë kam një pyetje për zotin Hysi meqë është i pranishëm në mbledhje dhe bashkë kemi diskutuar edhe herë të tjera. Do të doja të dija opinionin tuaj në lidhje me ndryshimet, që përcillen në ligj posaçërisht për shërbimin e provës. Si do ta ndryshojnë ato punën tuaj?

Engjëll Hysi – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, të nderuar anëtarë të Komisionit të Sigurisë Kombëtare!

Ndryshimet që propozohen, sepse u bë pyetja pse u bënë këto ndryshime, çfarë i dikton dhe është pyetje e drejtë, janë të gjitha të diktuara nga praktika. Po ju jap vetëm një shembull: ne kemi vonesa në sjelljen e urdhrave të ekzekutimit nga prokurorët. Prokurori thotë “Ma sjell me vonesë gjykata”, gjykata thotë “Unë nuk kam asnjë detyrim që t’ia çoj jashtë afateve të përcaktuara në ligj prokurorit të ekzekutimeve”. Ndryshimi që propozohet është që barra e përgjegjësisë i kalohet gjyqtarit, që ai, në kohën më të shkurtër, t’ia përcjellë vendimin e shkurtuar prokurorit të ekzekutimeve. Në këtë mënyrë fitojmë të gjithë kohën e ekzekutimit të vendimit penal dhe kjo nuk pret një apo dy vjet që të ndryshojmë ligjin e ekzekutimeve nga e para. Kini parasysh që neni 59 na ka futur të gjithëve në siklet. Ne bëmë ndryshimet e vitit 2018, por edhe me ndryshimet që propozohen, prapë problemi ngelet i pazgjidhur, sepse gjyqtari thotë që duhen 10 ditë kohë që vendimi të marrë formë përfundimtare, kurse në Kushtetutë ne kemi parashikuar që qytetari quhet fajtor kur vendimi ka marrë formën e prerë, disa prokurorë ndjekin linjën e formës së prerë si një e drejtë kushtetuese, disa të tjerë e sjellin të nesërmen sipas nenit nr. 59 të Kodit Penal.

Ndryshimi që ka të bëjë me përgjegjësinë e gjyqtarit për të përcjellë urgjentisht vendimin e shkurtuar, lind pikërisht nga neni 59 i Kodit Penal, sepse gjyqtarët japin dënim 14 vjet burg, dhe 28 ditë shërbim prove dhe neve na vjen urdhri i ekzekutimit 2 ditë pasi atij i ka mbaruar afati. Rrjedhja normale e afateve procedurale na vjen me shumë vonesë, prandaj kërkohet kjo urgjencë. Edhe ndryshimet që u bënë vjet kanë qenë një ndihmë shumë e madhe dhe kanë lehtësuar edhe prokurorinë, edhe shërbimin e provës në lidhje me ekzekutimin e dënimeve alternative.

Për sa u përket ndryshimeve të tjera projektligji “Për shërbimin e provës” zgjidh përfundimisht hierarkinë, vendin dhe pozicionin që tani janë të përcaktuara në ligjin e ekzekutimeve të vendimeve penale. Për rrjedhojë nuk ka pse të thuhet më në ligjin e ekzekutimeve penale çfarë është shërbimi i provës, ku është vendosur dhe si funksionon, sepse do të ketë një ligj të posaçëm, për rrjedhojë është e detyrueshme ndërhyrja që do të bëhet në ligjin e ekzekutimit të vendimeve penale. Tjetra, që e shpjegoi edhe zonja ministre, ka të bëjë me nenin 58 të Kodit Penal. Kanë qenë të papërcaktuar mirë roli dhe përgjegjësia e dy institucioneve. Ne kemi një marrëveshje mes Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Shërbimit të Provës, por në praktika na kanë lindur probleme. Prandaj rregullimi që bëhet në këtë projektligj zgjidh përfundimisht mënyrën e ekzekutimit edhe pse fatkeqësisht është një nen që është aplikuar shumë pak. Nuk e di arsyen pse gjykatat dhe prokuroritë hezitojnë, por praktikisht kemi vetëm një me nenin 58. Gjithsesi, në radhë të parë është detyra juaj pastaj e jona që të paktën në ligj ato të jenë të përcaktuara saktë. Kodi i Drejtësisë për të Mitur përcakton shërbimin e provës si institucioni që ka më shumë detyrimeve për të zbatuar, për rrjedhojë ato duhen pasqyruar edhe në ligjin e ekzekutimeve të vendimeve penale, përveç konceptit të masës së shmangies që del jashtë pjesës së ekzekutimit nga ana e prokurorit, e gjithë pjesa tjetër e veprave penale parashikohen nga shërbimi i provës si pjesë e një institucioni që ka ndoshta pjesën më të madhe të zbatimit të detyrimit për Kodin e Drejtësisë për të Miturit.

Në pamje të parë numri 38 duket shumë i madh, por shumë dispozita janë rregullime të karakterit gjuhësor, ose përshtatje gjuhësore dhe jo të gjitha ndryshimet që janë propozuar janë thelbësore, si, për shembull, detyrimet dhe përgjegjësitë e Policisë së Shtetit që parashikon Kodi Penal në nenin 30, pjesa tjetër nuk kanë të njëjtën rëndësi në ndryshimet e tyre.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Hysi, për përgjigjen tuaj!

A ka pyetje të tjera nga kolegë? Nuk ka.

Kalojmë në votimin në parim të ndryshimeve të përcjella.

Dua t'u bëj me dije kolegëve që gjatë kohës që vumë në lëvizje diskutimin e këtij projektligji, nuk kemi xhiruar bosh, në kuptimin që kemi ndenjur, por duke parë që në relacionin që shoqëron projektin thuhet që është bërë vetëm konsultimi elektronik i ndryshimeve të propozuara, ne e gjykuam që ishte e përshtatshme, edhe për vetë natyrën e ligjit, që të kishim mendimin e organit të prokurorisë dhe komentet e tyre ne i kemi marrë. Për hir të së vërtetës janë disa komente shumë të detajuara, të cilat do të donim që t'i kishin paraprakisht në duar jo vetëm anëtarët e komisionit, por edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, me qëllim që përpara se të fillojmë diskutimin nen për nen të projektligjit të mund të kemi një qëndrim të dakordësuar sipas komenteve, që na vijnë nga organi kryesor, i cili urdhëron dhe merret me zbatimin e ekzekutimit të vendimeve penale.

Kush është dakord me ndryshimet e propozuara në ligjin nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale” të ndryshuar”?”

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet .

Faleminderit kolegë!

Faleminderit përfaqësuesve të ministrisë, për praninë sot!

Do t'ju njoftoj për kalendarin në vijim.

Ditën e mirë!

MBYLLET MBLEDHJA